

L I G J
Nr.8165, datë 21.11.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7788, DATË 9.2.1994, 7899, DATË 2.2.1995 DHE NR.8079, DATË 29.2.1996

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.7788, datë 9.2.1994, nr.7899, datë 2.2.1995 dhe nr.8079, datë 29.2.1996 në nenin 2, rreshti i 8-të dhe në nenin 7, pika “dh” ndryshohen si vijon:

“Taksa për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, noteria dhe hipotekat”.

Neni 2

Në nenin 8, në pikën “A” “Për taksat nacionale”, nënpika “e” dhe “II” ndryshohen si vijon:

e) Për taksën për veprimet e shërbimit nga administrata gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, noteria dhe hipotekat 5%

nga kjo:

- për organet gjyqësore dhe hipotekat	2%
- për organet noteriale	0%
- për subjektet që janë të autorizuara sipas ligjit nr.8002, datë 27.9.1995 “Për përdorimin dhe administrimin e pullave të taksave”, për shitjen e pullave të taksës	3%
11. Për taksën e pullës dhe taksën mbi aktet	5%

Nga kjo:

- Për zyrat e gjendjes civile	2%
- Për subjektet që janë të autorizuara sipas ligjit nr.8002, datë 27.9.1995 “Për përdorimin dhe administrimin e pullave të taksave”, për shitjen e pullave të taksës	3%

Neni 3

Në nenin 8, pka “A” “Për taksat nacionale”, nënpika “c” ndryshohet si vijon:

c. Për taksën e qarkullimit rrugor ngarkohen degët e doganave në pikat e kalimit kufitar për karburantin që vjen nga importi, kurse për karburantin e prodhuar në vend ndërmarrjet prodhuese për sasitë që u shiten subjekteve të shitjes së karburanteve për shitjet me pakicë.

Neni 4

Në lidhjen nr.4 bëhen ndryshimet vijuese:

Titulli i lidhjes nr.4 do të zëvendësohet me fjalët “Taksa për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, noteria dhe hipotekat”.

Në pikën “A” fjala “juridike” do të zëvendësohet me fjalën “e shërbime”. Në nënpikën 1 të pikës “A”, pas fjalës “personave” të shtohen fjalët “fizikë e”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1658, datë 4.12.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha